



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/550  
Datë: 13/11/2020

Rektori i Universitetit të Prishtinës, në përputhje me mundësitë dhe kushtet reale të krijuara pas rritjes së rasteve pozitive me Corona Virus COVID-19 dhe në zbatim të Vendimin nr. 01/42 të datës 11.11.2020 të Qeverisë së Kosovës, nxjerr këtë

**VENDIM**

1. Universiteti i Prishtinës do të punojë vetëm me personel esencjal, i cili personel përcaktohet me vendim të secilës njësi akademike.
2. Administratat e njësive akademike dhe Administratës qendrore do të organizojnë punën në atë mënyrë që në secilën zyrë të ketë së paku një zyrtarë i cili do të punojë me rotacion. Orari i punës dhe forma e rotacionit përcaktohet nga sekretari i njësisë akademike për zyrtarë të fakulteteve, respektivisht nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë në Administratën qendrore.
3. Personat me sëmundje kronike, gratë shtatzëna dhe gratë gjdhënëse lirohen nga paraqitja në punë. Detyrat e punës nga personeli që i takon kategorisë së të punësuarve si në këtë paragraf, do të kryhen nga shtëpia.
4. Të gjitha njësitë akademike obligohen të mbikëqyrin në baza ditore paraqitjen e stafit në punë në përputhje me "Manualin për mbrojtje nga përhapja e COVID-19", përfshirë matjen e detyrueshme të temperaturës për të gjithë gjatë hyrjes në objekte.
5. Procesi arsimor organizohet në formën online, ndërsa provimet, puna praktike dhe laboratorike organizohen duke respektuar të gjitha rekomandimet e IKShPK-së dhe MSh-së.
6. Ndalohen të gjitha tubimet publike, përfshirë seminarët, punëtoritë dhe ceremonitë promovuese.
7. Në FEFS, lejohen aktivitetet sportive në hapësira të mbyllura dhe të hapura, stërvitjet dhe garat mund të organizohen në sportet individuale, gjatë stërvitjeve në hapësirat e mbyllura mund të marrin pjesë deri në 20 persona, ndërsa gjatë garave mund të marrin pjesë deri në 50 persona bazuar në protokolle dhe udhëzime vendore dhe ndërkombëtare sportive, si dhe duke u bazuar në "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e COVID-19".

8. Puna me palë të treta gjatë kësaj periudhe të reduktohet në maksimum, përveç në raste të veçanta.
9. Dekanët e njësive akademike obligohen që t'i ndërmarrin të gjitha masat për pajisje me dezinfektues të sallave apo laboratorëve ku do të mbahen ushtrimet praktike/laboratorike deri në përfundim të furnizimit të UP-së përmes tenderit publik.
10. Ky vendim fillon të zbatohet nga data 16.11.2020 dhe vlen deri në një vendim tjetër të Qeverisë.
11. Vendimi nr. 01/42 të datës 11.11.2020 i Qeverisë së Kosovës do të vlerësohet pas dy jave, varësisht nga situata epidemiologjike në vend.
12. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen të gjitha njoftimet paraprake të cilat i përcaktojnë kriteret e punës dhe organizimit të procesit mësimor në kushte të pandemisë.

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Menaxhmentit të UP-se;
3. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së;
4. Dekanëve të njësive akademike të UP-së,
5. Sekretarëve të njësive akademike;
6. Drejtorëve të zyrave;
7. Zyrtarëve të AQ-së;
8. Parlamentit të studentëve, dhe
9. Për publikim në ueb-faqe.



Prof. Dr. Naser Sahiti

*Naser Sahiti*  
Rektor i UP-së